



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
MINISTRI

U DH Ë Z I M

NR. 4557/, DATË 1 / 6 / 2017

PËR

REGJISTRIMIN E TITUJVE NË SHOQËRINË “QENDRA E REGJISTRIMIT TË AKSIONEVE” Sh.A TIRANË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 119, pika 5, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, *i ndryshuar*, të neneve 6 e 13 të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”,

UDHËZOJ:

1. Shoqëritë aksionare, të cilat rezultojnë të regjistruara në regjistrin tregtar, në rastet e ndryshimeve në lidhje me transferimin e aksioneve, kapitalin e regjistruar, numrin e aksioneve dhe/ose vlerën nominale të secilit aksion, kanë detyrimin e pasqyrimin të këtyre ndryshimeve në shoqërinë “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sh.a. Tiranë.
2. Titull sipas formës juridike, janë ato të përcaktuara në nenin 3 të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”.
3. Detyrimi për regjistrimin e titujve (aksioneve) në shoqërinë "Qendra e Regjistrimit të Aksioneve" sh.a. Tiranë, rrjedh nga pika 5 e nenit 119 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, *i ndryshuar*.
4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet shoqëria “ Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” Sh.A Tiranë dhe Shoqëritë aksionare të regjistruar në Regjistrin Tregtar.
5. Udhëzimi nr. 309, datë 03.06.2014 “Për regjistrimin e titujve në shoqërine “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” Sh.A Tiranë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

MILVA EKONOMI

